

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në bazë të nenit 32, paragrafi (3) të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19), ministri i Arsimit dhe Shkencës ka miratuar

RREGULLORE

PËR STANDARDET PROFESIONALE PËR TITULLIN MËSIMDHËNËS - MENTOR DHE MËSIMDHËNËS – KËSHILLTAR SI DHE MËNYRËN E FITIMIT TË TYRE

NENI 1

Me këtë rregullore, përcaktohen standardet profesionale për mësimdhënësin-mentor dhe mësimdhënësin-këshilltar në shkollat fillore dhe të mesme (në tekstin vijues: standardet) dhe mënyra e fitimit të tyre.

NENI 2

Standardet për mësimdhënësin-mentor përfshijnë njohuri, aftësi dhe shkathtësi që mësimdhënësi duhet të posedojë për të përparuar në titullin mësimdhënësi-mentor.

Standardet për mësimdhënësin-mentor grupohen në këto fusha:

1. Njohuri për lëndën mësimore dhe njohuri për sistemin arsimor;
2. Mësimdhënia dhe mësimnxënia;
3. Krijimi i një mjedisi stimulues për mësim;
4. Inkluzioni social dhe arsimor;
5. Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin dhe
6. Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional.

NENI 3

Standardet për mësimdhënësin-mentor, për fushën Njohuri për lëndën mësimore dhe njohuri për sistemin arsimor, i referohen njohurive teorike dhe praktike që duhet të posedojë mësimdhënësi-mentor për lëndën mësimore / lëndët mësimore që ligjëron dhe për njohuri rreth pozicionit të sistemit arsimor.

Mësimdhënësi-mentor për fushën Njohuri për lëndën e tij, të cilën e ligjëron dhe njohurive për pozicionin e sistemit arsimor, duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- posedon njohuri të thelluar dhe kuptuese për lëndën / lëndët mësimore që ligjëron,
- vlerëson dokumente lidhur me lëndën / lëndët mësimore në mënyrë kritike,
- ndan njohuri me kolegët e tij për çështje nga fusha e tij dhe
- zhvillon dhe zbaton politikat arsimore në shkollën e tij.

Neni 4

Standardet për mësimdhënësin-mentor, për fushën Mësimdhënia dhe mësimnxënia, i referohen njohurive dhe aftësive për planifikim dhe zbatim të mësimdhënies inovative dhe cilësore, që plotësojnë nevojat e nxënësve dhe ofrojnë arritje të larta.

Mësimdhënësi – mentor, në fushën Mësimdhënia dhe mësimnxënia duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- analizon planifikime sipas lëndës mësimore në nivel shkolle, propozon përmirësime dhe krijon politikat zhvillimore të shkollës.

- përdor metoda dhe teknika të reja efektive në mësimdhënie dhe në aktivitete jashtëmësimore dhe krijon e zbaton projekte inovative në nivel shkolle.

- përdor rezultate dhe / ose përmbajtje nga vlerësime të jashtme (kombëtare dhe ndërkombëtare) për të përmirësuar mësimdhënien, për të zhvilluar kritere dhe instrumente të vlerësimit në nivel shkolle,

- motivon dhe përgatit nxënësit për të arritur rezultate të larta.

- përdor metoda të ndryshme në mësimdhënien dhe

- ndan eksperiencën me kolegët.

Neni 5

Standardet për mësimdhënësin-mentor, për fushën Krijimi i një mjedisi stimulues për mësim, i referohen njohurive dhe aftësive për të siguruar mjete dhe materiale të nevojshme për lëndën mësimore duke përfshirë edhe mjetet digjitale për mësimin e lëndës.

Standardet lidhen edhe me aftësitë dhe shkathtësitë e mësimdhënësit-mentor për të kontribuar në punën në grup e të gjithëve në shkollë dhe për të bërë më të mirë mjedisin për jetë dhe punë.

Mësimdhënësi-mentor në fushën Krijimi i një mjedisi stimulues për mësim, duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- krijon një mjedis mësimor me materiale dhe mjete të ndryshme,

- zhvillon strategji dhe aktivitete për multikulturalizëm, interkulturizëm dhe integritet ndërkulturore e pjesëmarrje demokratike në punën mësimore dhe jashtëmësimore,

- përdor mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mënyrë kreative në mësimdhënie,

- zhvillon strategji për krijimin e një mjedisi të sigurt për mësim dhe

- krijon atmosferë shkollore pozitive dhe komunikim të mirë.

Neni 6

Standardet për mësimdhënësin-mentor, në fushën Inkluzioni social dhe arsimor, i referohen njohurive dhe aftësive për arsimin inkluziv, aftësinë për të siguruar praktika inkluzive dhe kontribut në përmirësimin e inkluzionit në shkollë.

Mësimdhënësi-mentor në fushën Inkluzioni shoqëror dhe arsimor, duhet të përmbushë standardin Zhvillimi i strategjive dhe mënyrave inkluzive të punës në shkollë.

Neni 7

Standardet për mësimdhënës-mentor, për fushën Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin, i referohen njohurive dhe aftësive për komunikim në mësimdhënie.

Mentori-instruktur në fushën Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin, duhet të përmbushë standardin e përmirësimit të bashkëpunimit të shkollës me familjen dhe komunitetin lokal.

Neni 8

Standardet për mësimdhënësin-mentor, për fushën Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional, i referohen njohurive dhe aftësive për përmirësimin e zhvillimit profesional të tyre dhe të kolegëve dhe për përparimin e bashkëpunimit në shkollë.

Mësimdhënësi-mentor në fushën Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- përsoset profesionalisht në kontinuitet duke marrë pjesë në forma të ndryshme të mësimi formal dhe jo formal në funksion të procesit arsimor,
- zhvillon dhe zbaton strategji shkollore për zhvillim profesional,
- kontribuon në zhvillimin profesional të kolegëve dhe
- promovon dhe praktikon modele etike të sjelljes në të gjitha llojet e komunikimit profesional (me nxënësit, kolegët dhe komunitetin më të gjerë).

Neni 9

Standardet për mësimdhënësin-këshilltar, përfshijnë njohuri, aftësi dhe shkathtësi që i posedon mësimdhënësi-këshilltar për t'u avancuar në titullin mësimdhënës-këshilltar.

Standardet për mësimdhënës-këshilltar janë grupuar në këto fusha:

1. Njohuri për lëndën mësimore dhe njohuri për sistemin arsimor;
2. Mësimdhënia dhe mësimnxënia;
3. Krijimi i një mjedisi stimulues për mësim;
4. Inkluzioni social dhe arsimor;
5. Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin dhe
6. Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional.

Neni 10

Standardet për mësimdhënë-këshilltar, për fushën Njohuri për lëndën mësimore dhe njohuri për sistemin arsimor, i referohen njohurive teorike dhe praktike që posedon mësimdhënësi-këshilltar për të vlerësuar në mënyrë kritike dokumentacionin lidhur me lëndën mësimore dhe fushat e afërta në nivel kombëtar dhe për të dhënë sugjerime të argumentuara për përmirësimin e tyre.

Mësimdhënësi-këshilltar për fushën Njohuri për lëndën mësimore dhe njohuri për sistemin arsimor, duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- përgatit materiale mësimore dhe materiale për mësimnxënie që janë recenzuar pozitivisht,
- posedon njohuri të thella dhe kupton fushën e lëndës,
- ndjek, analizon dhe përmirëson dokumente programore në nivel kombëtar dhe
- analizon dhe përgatit dokumenteve konceptuale dhe strategjike në arsim.

Neni 11

Standardet për mësimdhënësi-këshilltar, për fushën Mësimdhënia dhe mësimnxënia, i referohen njohurive dhe aftësive për të sjellë dhe promovuar inovacionet në mësimdhënie, në shkollën ku punon dhe mes kolegëve nga shkollat e tjera. Standardet i referohen edhe njohurive për kërkimeve në fushën e arsimit, zbatimit të projekteve inovative dhe përmirësimit të mësimdhënies bazuar në njohuritë e fituara.

Mësimdhënësi - këshilltar për fushën Mësimdhënia dhe mësimnxënia, duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- udhëheq në fushën e planifikimit zhvillimor të shkollës.
- krijon dhe zbaton projekte inovative në bashkëpunim me institucione tjera profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare,
- promovon qasje bashkëkohore në mësim ndër bashkësitë e gjera profesionale,
- ndihmon kolegët në krijimin e shembujve të praktikave të mira dhe në realizimin e hulumtimeve të veprimit,
- përgatit instrumente, standarde dhe raporte për vlerësimin e jashtëm në nivel kombëtar,
- përmirëson politikat shkollore për vlerësim dhe
- përmirëson efektivitetin e vlerësimit, duke përfshirë edhe përdorimin e analizave statistikore.

Neni 12

Standardet për mësimdhënësi-këshilltar, për fushën Krijimi i një mjedisi stimulues për mësim, i referohen njohurive dhe aftësive për sigurimin e një klime motivuese për mësim dhe një mjedis pune gjatë mësimdhënies dhe aftësive për të përfshirë të tjerët në aktivitete për rritjen e sigurisë fizike të nxënësve në shkollë dhe në komunitet.

Mësimdhënësi-këshilltar për fushën Krijimi i një mjedisi stimulues për mësim, duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- nxit aktivitete për një mjedis stimulues dhe të sigurt,
- krijon një klimë në shkollë dhe jashtë saj që karakterizohet nga transparenca, respekti dhe bashkëpunimi dhe
- zhvillon strategji dhe aktivitete për multikulturalizëm, interkulturalizëm dhe integrim ndëretnik dhe për pjesëmarrje demokratike, në nivel rajonal dhe kombëtar.

Neni 13

Standardet për mësimdhënës-këshilltar në fushën Inkluzioni social dhe arsimor, i referohen njohurive dhe aftësive për përmirësimin e politikave dhe praktikave arsimore dhe praktikave për arsim inkluziv në nivel rajonal dhe kombëtar.

Mësimdhënësi-këshilltar në fushën Inkluzioni social dhe arsimor, duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- punon për përmirësimin e inkluzionit të nxënësve në komunitetin e gjerë dhe
- përshtat mësimdhënien për zbatim në kushtet e shtëpisë, institucioneve edukative-korrektuese, dënuese-korrektuese dhe shëndetësore.

Neni 14

Standardet për mësimdhënës-këshilltar në fushën Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin, i referohen njohurive dhe aftësive për të krijuar rrjetet e bashkëpunimit me komunitetin lokal.

Mësimdhënësi-këshilltar në fushën Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin, duhet të përmbushë standardin e mëposhtëm:

- ndërton partneritetin e shkollës me komunitetin lokal për të rritur përgjegjësinë shoqërore.

Neni 15

Standardet për mësimdhënës-këshilltar në fushën Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional, i referohen njohurive dhe aftësive për të analizuar, hulumtuar dhe përparuar praktikën e tyre dhe aftësitë për të krijuar dhe udhëhequr ekupe bashkëpunuese për përmirësimin e praktikave mësimore.

Mësimdhënësi-këshilltar në fushën Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional, duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

- krijon dhe zbaton strategji dhe dokumente për zhvillim profesional në nivel rajonal dhe kombëtar,
- përsoset profesionalisht dhe përsosje shkencore në kontinuitet përmes pjesëmarrjes në forma të ndryshme të mësimin formal dhe joformal në fushën lëndore apo në fushën e arsimit,
- krijon dhe udhëheq ekupe rajonale të mësimin dhe rrjete profesionale për shkëmbim të përvojave dhe
- zhvillon programe të zhvillimit profesional në shkollë.

Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën pas publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 18-4882/1
6 maj 2020
Shkup

ministri i Arsimit dhe Shkencës,
Dr. Arbër Ademi, nënshkrim me d.v.